



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 312/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala Kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e parashtruar nga subjekti politik Bošnjaka Jedinstvena Lista (BJL), në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hudhet si e palejueshme ankesa me numër: Anr.312/2014 e datës 09.06.2014, e parashtruar në PZAP nga subjekti politik Bošnjaka Jedinstvena Lista (BJL).

Arsyetim

Subjekti politik Bošnjaka Jedinstvena Lista (BJL), me datë 09.06.2014, kundër vendotimit Nr.3802B/01R dhe 3802B/02D, në Mitrovicën Veriore, mirëpo në bazë të parashtresës të datës 10.06.2014, ka deklaruar se ankesën e parashtruar ta tërheq.

Ankesa hudhet si e pasafatshme, e parregullt dhe e palejueshme dhe se ankesa është e palejueshme në rast se është parashtruar nga ana e personit të paautorizuar për paraqitjen e saj, por ankesa është e palejueshme në rast se të njëjtën e tërheq ose nga e njëjta heq dorë ankuesi e në rastin konkret për shkak se është tërhequr ankesa, e njëjta është dashur të hedhet poshtë si e pa lejueshme sipas nenit 186 paragrafi 3 të LPK-së.

Andaj, në kuptim të nenit 115.1 të LZP - së, PZAP -i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 312/2014 më datën 11.06.2014.

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

